



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION*

KUSHTET E VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ("Autoriteti Kontraktues"),

dhe

"Mobelland" SH.P.K Suharekë

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS:

Furnizim me Inventar (Ri mobilimi i sallës)

Numri i identifikimit: 212 19 6375 136

Numri i brendshëm: 212 19 012 136

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

03 Tetor 2019

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizim me Inventar (Ri mobilimi i sallës)**

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi Pa TVSH - €	TVSH (%)	ÇMIMI NJË ME TVSH	Çmimi total me TVSH €	Koha dërgesës
1.	Varëse për garderobë: Varësja të jetë e përbërë me 5 varëse, tub rrethore me Ø 35mm, dim. 180 cm min., me vend në pjesën e poshtme të strukturës për vendosjen e çadrave.	Copë	3	25.42	18%	30	89.99	15 ditë
2.	Sirtar: Sirtar (komodinë) me katër fioka, sirtar rrëshqitës (55x40x60cm). Pjesa e sipërme dhe ajo ballore nga pllaka MDF i plastifikuar min. d=18mm, konstruksioni të jetë nga pllakë zdrukthi melamine min. d=18mm me shirit, ngjyra e kaftë. Në pjesën fundore duhet të ketë rrota në mënyrë që të jetë e lëvizshme.	Copë	3	42.37	18%	50	149.99	15 ditë
3.	Karriga kualitative statike: Karriga statike me strukturë nga aliazhet e metalit, në formë të shkronjës U. Mveshja e ulëses nga materiali i tekstilit, mbështetësja rrjetë tekstili kurse mbajtëset e duarve të janë plastik. Dim: ~56-60 x ~54-56 x ~(L)95-100cm. Ngjyra dhe dizajni	Copë	30	33.90	18%	40	1,200.06	15 ditë

Nr. i Prokurimit: 212 19 6375 136 & 212 19 012 136 Titulli: Furnizim me Inventar (Ri mobilimi i sallës)

	përcaktohen nga Autoriteti Kontraktues.							
4.	Tavolina lëvizëse e takimeve: Tavolina si tërësi të jetë e përbërë nga tavolina të ndara, përmundësi lëvizjeje që të kombinohen sipas nevojës. Materiali i tavolinave të jetë nga mediapani i plastifikuar me cilësi dhe dizajn i caktuar më vonë me marrëveshje nga Autoriteti Kontraktues. Sipërfaqja e rrafshët duhet të jetë me trashësi min. 30mm. Tavolina duhet të ketë mbajtësin për kabllo të vendosur në formë diskrete. Sipërfaqja që zë tavolina pas kombinimit sipas nevojës është me dim~380x~180cmx(L)~73-78cm. Ngjyra dhe dizajni përcaktohen nga Autoriteti Kontraktues.	Copë	1	847.46	18%	1,000.00	1,000.00	15 ditë
5.	Folie ngjitëse me logo të Mapl-së: për xham, me dim. 170x190cm. Ngjyra dhe dizajni përcaktohen nga Autoriteti Kontraktues.	Copë	1	84.75	18%	100.01	100.01	15 ditë
Totali i Përgjithshëm:							2,540.04 €	

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit: me 03.10.2019. Kohëzgjatja e kontratës fillonë nga data: 03.10.2019 deri me 02.02.2020.

Furnizimet fillojnë nga data: 03.10.2019 në afat prej 20 ditësh kalendarike.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [90] ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i **[dërgimit të furnizimeve]** [ekzekutimit të punëve] [kryerjes së shërbimeve] do të jetë: Ndërtesa e ish "Rilindjes", kati i 12, Salla nr.1220, Divizioni i Prokurimit MAPL, Prishtinë

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **2,540.04 €** [shëno çmimin total në shifra];
Dy mijë e pesëqind e katër dhjet euro e katër cent [shëno çmimin total me shkrim].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1, më sipër duhet të jetë e vëtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

[nëse kontrata përbëhet nga me shume se një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **[furnizimeve] [shërbimeve] [punëve]** duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të **[furnizimeve] [shërbimeve] [punëve]**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët]** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]** të pa dorëzuar deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshterinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshteria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykate për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmon ton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori

Nr. i Prokurimit: 212 19 6375 136 & 212 19 012 136 Titulli: Furnizim me Inventar (Ri mobilimi i sallës)

Ekonominik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **[specifiko gjykatën kompetente]** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

**Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal,
Ndërtesa e ish "Rilindjes", katë i 12, Salla nr.1220, Divizioni i Prokurimit MAPL, Prishtinë**

Personi përgjegjës i prokurimit i Autoritetit Kontraktues

Emri dhe Mbiemri: **Zelihe Morina**
Titulli: **U.D Udhëheqëse e Divizionit të Prokurimit**
Nr. i Tel: + 381 (038) 200 35 523
E-maili: **zelihe.morina@rks-gov.net**

Menaxher i proketit nga MAPL-ja:

Emri dhe Mbiemri: **Blerdon Pajaziti**
Titull: Zyrtar i lartë i personelit
Nr. i telefonit: 038/ 200 35 539
E-mail: **blerdon.pajaziti@rks-gov.net**

Adresa e Kontraktuesit:

"Mobelland" SH.P.K Suharekë
Numri i Biznesit: 810107393
Nr. I llogarisë bankare: 1502040002522850
Menaxheri i projektit nga Operatori Ekonomik

Emri dhe Mbiemri: **Hajrulla Morina**
Titulli: Menaxher
Nr. i telefonit: 044 606 369
E-mail: **info@mobelland.net**

E hartuar në gjuhen **Shqipe** ² në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Nr. i Prokurimit: 212 19 6375 136 & 212 19 012 136 Titulli: Furnizim me Inventar (Ri mobilimi i sallës)

Për Autoritetin Kontraktues: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal		Për Operatorin Ekonomik: "Mobelland" SH.P.K Suharekë	
Emri:	Zelihe Morina	Emri:	<i>Zelihe Morina</i>
Pozita:	U.D Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit	Pozita:	<i>Z. Morina</i>
Nënshkrimi:	<i>Z. Morina</i>	Nënshkrimi:	<i>Z. Morina</i>
Data:	03.10.2019	Data:	03.10.2019
Vula:		Vula:	



